VENDIM
Nr.63, datë 13.9.2010

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR FURNIZUESIN PUBLIK ME SHUMICË PËR VITIN 2011

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, të neneve 20, 21 të "Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.21, datë 18.3.2009, të vendimit nr.78, datë 26.6.2008 "Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për furnizuesin publik me shumicë të energjisë elektrike", Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 13.9.2010, pasi shqyrtoi aplikimin e KESH sh.a. për përcaktimin e tarifës së energjisë elektrike për furnizuesin publik me shumicë, për vitin 2011 dhe relacionin e grupit të punës,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për përcaktimin e tarifës së energjisë elektrike për aktivitetin e furnizimit publik me shumicë për vitin 2011.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e KESH sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Bujar Nepravishta